



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

**V E N D I M**

Nr. 1 datë 18/01/2019

“Për

miratim në parim/ autorizim për përdorim burimi ujqor, për prodhim hidroenergji, për subjektin “Endri Peshku” sh.p.k, për hec-in “Peshku Energy”, me vendndodhje, përroi i Xixullës, degë e Lumit Mat, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër”.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Per Menaxhimin e Integruar te Burimeve Ujqore”, të ndryshuar , vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujqore”, si dhe nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015,“Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni” , me propozim te A. B. U. Mat  
Këshilli i Basenit Ujqor Mat;

**Vendosi:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “Endri Peshku” sh.p.k, me Administrator z. Aleksandër Peshku, për “Përdorim të Rezervave Ujqore për Energji Elektrike “ sipas studimit të paraqitur, me këto të dhëna:

**HEC - “Peshku Energy” / Në përroi e Xixullës, degë e Lumit Mat**

**Vepra e marrjes 1**

- Prurja mesatare 0.26 m<sup>3</sup>/sek
- Prurja llogaritese 0.5 m<sup>3</sup>/sek
- Prurja ekologjike 0.067 m<sup>3</sup>/sek.
- Kuota e Vepra e marrjes : X – 5 19 981                      Y- 45 80 659                      Z – 1370 m.m.n.d
- Kuota e godines se HEC : X – 5 17 778                      Y- 45 81 302                      Z – 1220 m.m.n.d
- Fuqia e instaluar : 380 kW
- Kapaciteti prodhues mesatar: 668 100 kwh/vit

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me uje të popullatës e tjere , nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I Z.A.B.U. ISHEM-ERZEN-MAT  
Adrian SHTINO

KRYETARI I K.B.U. MAT  
Gjergj PRENDI

